



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 851/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 6 /2018

**V E N D I M**

**Nr. 135 , Datë 13 / 6 / 2018**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 42, datë 28.03.2018, të paraqitur nga Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane-Rome” kundër faqes facebook të portalit “Jeta Osh Qef”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: “*Portali mediatik, Jeta Osh Qef (joq.al) në datë 17.03.2018, 1.41am ka publikuar në faqen e saj facebook (<https://www.facebook.com/JETAOSHQEF/posts/10155768401543371>) një material nëpërmjet të cilit transmeton një mesazh të një personi i cili shpreh haptazi diskriminim për komunitetin rom duke i quajtur harixhinj, gabel dhe racë e zezë. Ky është një mesazh që nuk duhej shfaqur nga portali duke qenë se nxit diskriminim*”.

Konkretisht mesazhi si më poshtë:

*“Përshëndetje JOQ. Unë që po shkruaj jam një punonjës në një firmë ndërtimi, por kam një hall të madh se vendi ku unë punoj është i mbushur me rom me gabel me harrigjinjë ku di unë këto rracë e zezë dhe nuk të lënë për të punuar shkojnë hipin në mjete dalin para makinerive nuk ikin kur punohet me eskavator jemi në hall të madh para disa ditësh vdiq njëri që e zuri skorja ku po mblidhte skrap, është bërë e pa mundur të punojmë, kemi njoftuar me qindra herë policinë por nuk ka ç'farë bën dhe policia se nuk ikin ato. Po ju dërgojmë dhe ca foto të frikshme që po na ndodhin në punë jashtë çdo kushti normal, jemi në hall”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës është shkak i mbrojtur nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

*Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:*

- Me shkresën nr. 440/1, datë 12.04.2018 është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Portalin “Jeta Osh Qef” në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim në adresën e dhënë nga ankuesi.

Në datë 16.04.2018, Posta Shqiptare ka kthyer zarfin nr. prot 440/1 me Barkode: RR 244992194 AA, me përgjigjen: “Adresë e pamjaftueshme”.

Në vijim të procedurave hetimore, me shkresat nr.440/2, datë 12.04.2018 dhe nr.440/3, datë 27.04.2018 për identifikimin e subjektit JOQ.al, Komisioneri i është drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me shkresat nr.1120/1, datë 23.04.2018 dhe nr.1120/3, datë 30.04.2018 ka informuar Komisionerin me të dhënat e poseduesit të domain-it: joq.al.

- Me shkresën nr. 440/5, datë 04.05.2018 është bërë njoftimi dhe kërkesa për informacion për Portalin “Jeta Osh Qef” në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim në adresën e deklaruar nga subjekti me NUIS L31709014G në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në datë 05.05.2018, Posta Shqiptare ka kthyer zarfin nr. prot 440/5 me Barkode: RR 263040749 AA, me përgjigjen: “I panjohur”.

Në vijim të përpjekjeve për të kontaktuar me subjektin: “Jeta Osh Qef”, në datë 19.05.2018, ora 6.15 pm i është dërguar njoftimi i Komisionerit nëpërmjet adresës elektronike: [info@joq.al](mailto:info@joq.al).

Duke qenë se përsëri nuk kishte reagim nga subjekti: “Jeta Osh Qef” në datë 29.05.2018 në orën 13.57 është njoftuar subjekti përmes rrjetit social Facebook<sup>1</sup> dhe mesazhi i Komisionerit është parë nga administratorët e faqes në orën 14.21 të datës 29.05.2018. Gjatë periudhës së muajit Maj 2018 është telefonuar disa herë në numrin +355674052951 të deklaruar nga subjekti me NUIS L31709014G në Qendrën Kombëtare të Biznesit por numri i telefonit ishte jashtë shërbimi. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihej në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe të merrte masa për heqjen nga faqja dhe ç’aktivizimin e aksesit për publikun të materialit të publikuar në datë 17.03.2018, 1.41am.

Në datë 05.06.2018, zyra e Komisionerit ka denoncuar në rrjetin facebook.com mesazhin e publikuar në datë 17.03.2018, 1.41am nga Jeta Osh Qef si mesazh me përmbajtje diskriminuese dhe ka kërkuar nga autoritetet e facebook-ut bërjen të mundur të heqjes nga publikimi të mesazhit objekt i ankesën dhe po në këtë datë nga facebook.com është bërë i mundur heqja e mesazhit.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij janë bazat e shtetit shqiptar<sup>2</sup>. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por edhe të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin e tyre nga privatët. Pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për ti mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

### **Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vëren se:**

Shqipëria ka nënshkruar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14<sup>3</sup>, garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin nr.12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin e të drejtave pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Në vitin 2003 Këshilli i Evropës, miratoi Protokollin shtesë të Konventës për Krimin në Fushën e Kibernetikës, lidhur me kriminalizimin e akteve të një natyre raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike. Referuar nenit 2 të këtij protokolli, si material racist dhe ksenofobik konsiderohet: “Çdo material i shkruar, çdo fotografi ose çdo prezantim tjetër i ideve dhe teorive të cilat përfaqësojnë, promovojnë ose nxisin urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër

<sup>1</sup> <https://www.facebook.com/antidiskriminimi/>

<sup>2</sup> Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.

<sup>3</sup> Neni 14, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - Ndalimi i diskriminimit “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”.

*individit ose grupit të individëve, të bazuara në racë, ngjyrë, paraardhës ose prejardhje kombëtare apo etnike, si dhe feje nëse përdoret si pretekst për cilindo qoftë nga këta faktorë*<sup>4</sup>.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>5</sup>.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të racës dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në bazë të nenit 3, pika 2 e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>6</sup>. **Për këtë arsye, në analizën që i është bërë gjuhës së përdorur në mesazhin e postuar në faqen e facebook-ut, nëse ato do të konsiderohen në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.**

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

<sup>4</sup> Përkthim i Komisionerit.

<sup>5</sup> Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.*

<sup>6</sup> Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur (gabel, harixhinj dhe racë e zezë) në mesazhin e publikuar në datë 17.03.2018, ora 1.41 am në faqen facebook të JETA OSH QEF është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn<sup>7</sup> ku është shprehur se: “..... mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e firmës Feryn, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë duke mos patur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standardi të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standardi të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që portali “Jeta Osh Qef” është një faqe e ndjekur nga shumë njerëz dhe pjesëmarrësit për shkak të shikueshmërisë janë persona publikë. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet medias sociale përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit.

Praktika e vendosur nga portali “Jeta Osh Qef”, përmes publikimit të një informacioni në faqet e tij on-line, për persona apo grupe personash që i përkasin komunitet rom, mund të kontribuojë në mbajtjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetin rom në Shqipëri.

Në pikën 1/b, të nenit 17 të Ligjit Nr. 10 128, datë 11.05.2009 “Për Tregtinë Elektronike”, parashikohet që: “Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit: a) ..... b) me marrjen e këtij informacioni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në informacion.”

Duke iu referuar çështjes Delfi AS kundër Estonisë<sup>8</sup>, vërejmë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashtroi se: “...duhet të mbahet përgjegjësi, në parim, për gjuhë shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme dhe kjo të përbëjë mjet efektiv ndaj cenimit të personalitetit të individëve.

<sup>7</sup> Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008

<sup>8</sup> Delfi AS kundër Estonisë, çështja nr. 64569/09, Vendimi datë 10.10.2013, Nota Informative 167.

*Për më tepër, Gjykata vërejtë që, në rastin në fjalë, komentet e kontestuarra përbënin gjuhë të urrejtjes dhe nxitje të drejtpërdrejtë për dhunë, që portali i lajmeve i kompanisë kërkuese ishte një nga mediat më të mëdha të internetit në vend dhe që kishte pasur shqetësim publik në lidhje me natyrën kontradiktore të komenteve që ai tërhoqte”.*

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës<sup>9</sup>. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditin apo shqetësojnë” të tjerët<sup>10</sup>.

Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtëruar a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”.*

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5 dhe 7 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të shtetasve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e medias sociale JETA OSH QEF për shkak të racës në formën e shqetësimit.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, nga ana e administratorit të medias të sipërcituar, të merren masa që në të ardhmen të ndalohet postimi i komenteve diskriminuese ndaj personave që i përkasin komunitetit rom/egjiptian apo çdo personi tjetër.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Administratori i medias on-line: Jeta Osh Qef, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas

<sup>9</sup> Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ.

<sup>10</sup> Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07 dhjetor 1976.

parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: raca)

(fusha: te mira dhe sherbime)